



BASHKIA TIRANË
NJËSIA ADMINISTRATIVE TIRANË
NJËSIA BASHKIAKE NR. 8

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2017

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot në datën 15.11.2017, në ambjentet e Njesisë Administrative Nr. 8, mbi: ***“Dëgjese publike për projekt-buxhetin e vitit 2018 për Njësine Administrative Nr. 8, Bashkia Tiranë”***.

Morën pjesë në këtë takim, i deleguar nga Bashkia Tiranë,

- Z. Erindi Bejko, Drejtor i Përgjithshëm i Objekteve në Bashkëpronësi, Koordinimit me Njësitet Administrative dhe Emergjencave Civile.
- Administratori i Njesisë Nr. 8, z. Erjon Xhafa
- Staf i Njesisë Administrative Nr. 8
- Ndërlidhësit me komunitetin si edhe qytetarë nga Njesia Administrative Nr. 8

Z. Erjon Xhafa, Administrator i Njesisë nr. 8, mban një fjalim përshëndetës dhe një prezantim të punës së realizuar gjatë vitit 2017. **Z. Xhafa** theksoi se u punua në zgjidhje të problematikave dhe kërkesave të banorëve të Njesisë Administrative Nr. 8 dhe një fokus të madh patën investimet në çerdhet, kopshtet, dhe shkollat në territorin e Njesisë nr.8 shkollat.

Z. Erindi Bejko shpjegon këndvështrimin e Bashkisë Tiranë për buxhetin, në mënyrë që investimet e parashikuara të jenë në zbatim të nevojave më imediate të cilat kanë dalë gjatë bisedimeve me komunitetin. Thekson se në vitin 2018 do të përfundojnë edhe punët që kanë nisur në vitin 2017 dhe do të vijojnë investime të tjera në zonë tepër të rëndësishme për komunitetin .

Duke u ndalur te investimet për vitin 2017, z. Bejko paraqet ndërhyrjet që janë parashikuar për vitin në vazhdim si më poshtë :

- Përfundimi sa më shpejt i rikualifikimit të bllokut “Besa”-“Siri Kodra” – “ 5 maji”.
- Rikualifikimi i bllokut që kufizohet nga rrugët e ”Dibrës”-“Ibrahim Muzhiqi”-“Ferit Xhajko”
- Rikonstruksioni i rrugës “Ymer Beqiri”.
- Rikonstruksioni i rrugës “Xhemal Sheh Abazi”.
- Rikonstruksioni i rrugës “Ahmet Qoralliu”.
- Rikonstruksioni i rrugës “Bexhet Nelku”.
- Rikonstruksioni i Bibliotekës Nr. 3.

Diskutime

Pas prezantimit të projekt-buxhetit fjalën e kërkon **z. Agim Kurti**, ndërlidhës me komunitetin për zonën 1942, i cili ngre shqetësimin për disa rrugë në zonën 1942 si rruga “Mustafa Caslli”, rruga “Farudin Nuri” të cilat janë problematike për tu kaluar nga fëmijët në dimër kur shkojnë në shkollë. Gjithashtu **z. Kurti** kërkoi mundësi transporti për fëmijët e zonës për të shkuar në shkollë, duke qënë se institucionet arsimore janë larg nga zona.

Z. Erindi Bejko theksoj se është projektuar ndërtimi i një shkolle të re në rrugën “Dervish Luzha”, që do të ketë të integruar edhe kopshtin.

Z. Erjon Xhafa u shpreh se disa rrugë kërkojnë ndërhyrje, pasi janë prishur nga ndërhyrjet e UKT dhe i kanë kaluar Drejtorisë së Punëve Publike.

Takimi u mbyll me një falenderim për të gjithë pjesëmarrësit!

